



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 272 Prot.

Roskovec, më 16.01.2023

NJOFTIM

PËR

**VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN “KUZHINIERE” NË ÇERDHEN PUBLIKE
BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 23.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse për vitin 2023”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 02/1 prot. datë 06.01.2023, si dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 11, datë 16.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, për vitin 2023”,

Bashkia Roskovec shpall 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Kuzhinierë” në Çerdhen Publike Roskovec.

A. Disa nga detyrat funksionale të “Kuzhinierit të Çerdhes” janë:

Është punonjës në varësi të Përgjegjësit të Çerdhes. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

1. Të ruaj higjenën personale dhe të mbaj veshur uniformën e punës për çdo ditë.
2. Të kujdeset që ushqimi të jetë i freskët dhe të shërbehet i freskët te fëmijët.
3. Të përgatisë sasine e ushqimit sipas normës ditore të fëmijëve prezent të raportuar nga Përgjegjësi i Çerdhes.
4. Mban përgjegjësi që ushqimet të jenë të gatuar para se t’ju shërbehet vakti dhe jo nga dita e mëparshme.
5. Është përgjegjëse që vakti të shërbehet në orën dhe sipas menisë javore/ditore të përcaktuar.
6. Të ruajë në frigorifer mostra të ushqimeve të përgatitura ditën e mëparshme.
7. Kryen procesin e higjenizimit të mjeteve të kuzhinës.
8. Të zbatojë orarin zyrtar, disiplinën dhe etikën profesionale në punë.
9. Zbaton dhe detyra të tjera të ngarkuara nga Përgjegjësi i Çerdhes.

B. Kriteret e punësimit të “Kuzhinier Çerdheje”:

- Të ketë arsimin e mesëm dhe kurs kuzhine;
- Kualifikime të ndryshme në fushën e kulinarisë

C. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Vërtetim banimi
- Çertifikatë personale dhe familjare
- Librezë pune origjinale
- Raport mjeko – ligjor
- Dëshmi penaliteti
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme si dhe kursit për kuzhinier
- Kualifikime të ndryshme në fushën e kulinarisë

Afati i fundit i paraqitjes së aplikimeve është më datë 24.01.2023.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Sektorin e Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë Roskovec.

KRYETARI
Majlinda Bufi

